

Fletë Informativ nga BreastScreen Victoria

Para kontrollit të gjirit



- Diskutoni historinë familjare të kancerit.
- Vishni një bluzë dhe pantallona ose fund.

Gjatë kontrollit



- Do të hiqni bluzën në privatësi; kërkonin një mantel nëse dëshironi.
- Pajisja do të ushtrojë presion mbi gjoksin tuaj në mënyrë të fortë për të marrë imazhet me rreze X.

Pas kontrollit



- Do t'ju dërgojmë rezultatet tuaja brenda 2 deri në 4 javë.
- Nëse janë të nevojshme teste të tjera, do t'ju kërkojmë të vini përsëri.

Pas 2 vitesh



- Ne ftojmë shumicën e njerëzve për një kontroll të gjirit çdo 2 vjet.
- Vizitoni mjekun nëse vini re ndonjë ndryshim mes kontrolleve/mamografive.

Para kontrollit të gjirit

Kush është BreastScreen Victoria?

BreastScreen Victoria është pjesë e akredituar e BreastScreen Australia – programi kombëtar i kontrollit për kancerin e gjirit. Ne ftojmë vikorianet të moshës 50 deri në 74 për një kontroll falas të gjirit (mamografi) çdo 2 vjet. Ne ju japim kontrata ofruesve/klinikave publikë dhe privatë të shërbimeve shëndetësore për të realizuar kontrollet në të gjithë Viktorian.

Çfarë është një kontroll i gjirit?

Mamografia e Gjirit është një radiografi me rreze X me dozë të ulët për gjirin, e rekomanduar çdo 2 vjet për persona të moshës 50–74 vjeç. Ne BreastScreen Victoria, zakonisht marrim dy imazhe për secilin gj – një nga sipër dhe një nga anash. Mamografite e gjirit mund të zbulojnë kancere shumë të vegjël që nuk mund të ndjehen. Sa më herët të zbulohet kanceri, aq më të suksesshme janë trajtimet.

A janë të sigurt mamografite

Sa herë që bëni mamografinë e gjirit, gjoksi juaj ekspozohet ndaj një sasive shumë të vogël të rrezatimit. Studimet tregojnë se përfitimet nga zbulimi i hershëm i kancerit janë më të mëdha se rreziqet nga rrezatimi.

Çfarë ndodh nëse vërej ndryshime në gjoks?

Është e rëndësishme të njihni pamjen dhe ndjesinë normale të gjoksit tuaj. Nëse vini re ndonjë ndryshim në gjirët tuaj si një gungë e re, rrjedhje nga thithat apo skuqje, vizitoni menjëherë mjekun. Ju lutemi, mos shkoni për vizitë ne BreastScreen Victoria në këtë rast.

A duhet të sjell imazhet e mëparshme të radiografisë të gjirit?

Nëse keni bërë më parë një kontroll/mamografi – në BreastScreen Victoria ose privatisht – është e rëndësishme të

kemi një kopje të radiografive të mëparshme për krahasim. Kjo përmirëson saktësinë e rezultateve të imazheve të gjirit.

Kur rezervuat takimin tuaj, ne ju pyetëm nëse mamografia juaj e fundit ishte bërë nga BreastScreen Victoria. Nëse përgjigja juaj ishte po, ne ju ofruam opsionin për të mbajtur imazhet tuaja me rreze X në mënyrë elektronike me lejen tuaj. Si alternativë, ne ju kërkuam që të sillni imazhet tuaja me rreze X në takimin tuaj.

A do më duhet të ndaj historinë time familjare?

Ne mbledhim/marrim informacion për historinë familjare të kancerit të gjirit dhe të vezoreve për tju ofruar një kujdes më të mirë. Ky informacion na ndihmon në vlerësimin e rrezikut tuaj personal për zhvillimin e kancerit të gjirit.

Para se të plotësoni formularin e regjistrimit, bisedoni me familjen për historinë shëndetësore të familjes tuaj. Për më shumë informacion, vizitoni: breastscreen.org.au/family-history

Nëse kam implante gjiri?

Shumica e njerëzve me implante mund të bëjnë kontrollin e gjirit/mamografinë. Ju lutemi lexoni fletën me titullin “Kontrolli i gjirit/mamografi me implante” në breastscreen.org.au/resources/community

Ne nuk ofrojmë këshilla për problemet me implantet. Nëse keni shqetësime rreth implanteve tuaj, ju lutemi vizitoni mjekun tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Çfarë duhet të vesh ne takimi?

Rekomandojmë të vishni fund ose pantallona dhe një bluzë në takimin tuaj. Kjo e bën më të lehtë heqjen e bluzës për të bërë kontrollin. Ju lutemi mos vini shumë bizhuteri. Nëse keni flokë të gjatë, sillni një lidhëse ose lidhni flokët.

Po sikur të kem planifikuar të udhëtoj menjëherë pas kontrollit të gjirit?

Rezultatet e imazheve të gjoksit do të shqyrtohen nga të paktën dy profesionistë shëndetësorë të trajnuar specifikisht për këtë punë përpara se t'ju dërgohen juve. Ky proces zgjat rreth 2 deri në 4 javë. Prandaj, rekomandojmë të lini 4 deri në 6 javë para çdo udhëtimi dhe takimit tuaj për mamografinë. Ju lutemi njoftoni recepsionisten ose radiografin nëse planifikoni të udhëtoni brenda 4 deri në 6 javë mbas takimit për mamografi.

Gjatë kontrollit të gjirit/mamografisë

Çfarë ndodh në takim?

Një anëtare e ekipit tone do t'ju mirëpresë dhe do t'ju shpjegojë procesin e kontrollit të gjirit/mamografisë. Një radiografe femër do t'ju çojë në dhomën e mamografisë. Ju lutemi kërkonin një mantel nëse dëshironi. Kur të jeni gati, ajo do të marrë të paktën dy imazhe me rreze X për secilin gj. Procesi zgjat rreth 10 minuta.

A mund të flas me radiografin?

Jeni të mirëpritur të flisni me radiografin. Ajo do t'ju përgjigjet me kënaqësi për çdo pyetje ose shqetësim që mund të keni.

A dhemb kontrolli i gjirit/mamografia?

Është normale të ndjeni pak shqetësim për disa sekonda gjatë kontrollit/mamografisë. Shkaku i shqetësimit është pasi gjoksi shtypet fort mes dy pllakave të pajisjes të mamografisë për të marrë imazhe të qarta me rreze x. Njoftoni radiografin nëse ndjeni dhimbje – ajo do të përpqet që mamografia juaj të jetë sa më e rehatshme. Mund ta ndërprisni kontrollin/mamografinë në çdo moment.

A është e nevojshme shtypja e gjoksit?

Ka disa arsye të rëndësishme pse duhet të kompresojmë/shtypim gjinjtë tuaj gjatë një mamografie të gjirit. Shtypja i mban gjinjtë të palëvizshëm dhe zvogëlon lëvizjen, duke përhapur dhe ndarë indin e gjirit në mënyrë që të mund të marrim imazhe të qarta me rreze X. Gjithashtu zvogëlon sasinë e rrezatimit të kërkuar për secilën imazh me rreze X.

Pas kontrollit të gjirit/mamografisë

Kur do ti marr rezultatet?

Imazhet tuaja me rreze X të gjirit do të shqyrtohen në mënyrë të pavarur nga dy ose më shumë profesionistë të trajnuar shëndetësorë. Rezultatet tuaja do t'ju dërgohen brenda afërsisht 2 deri në 4 javësh. Ato do t'i dërgohen edhe mjekut tuaj nëse na jepni të dhënat e tyre.

A do të më kërkohet të kthehem për teste të tjera?

Mund t'ju kërkohet të vini përsëri ne BreastScreen Victoria për të bërë teste të tjera nëse një zonë e imazhit të gjirit tuaj kërkon hetim të mëtejshëm. Shumica e klientëve që ju kërkojmë të vijnë përsëri nuk kanë kancer. Nëse është kontrolli/mamografia juaj i parë, ka më shumë mundësi t'ju kërkohet një rikthim pasi nuk kemi imazhe me rreze x për krahasim.

Ku bëhen testet e mëtejshme?

Teste të mëtejshme mund të kryhen në vendndodhje të ndryshme nga takimi juaj fillestar për kontrollin e gjirit. Ne kemi klinika të specializuara vlerësimi në të gjithë shtetin, të pajisura me teknologji për të kryer çdo test shtesë të nevojshëm.

A i zbulon të gjitha kanceret një kontroll gjiri?

Mamografitë e gjirit janë mënyra më e mirë për të zbuluar kancerin e gjirit në një fazë të hershme. Megjithatë, ato nuk janë 100% të sakta. Ekziston një shans i vogël që imazhet me rreze X të gjirit të duken normale edhe nëse është i pranishëm kanceri i gjirit.

Dy vjet më vonë

Çfarë ndodh kur më duhet kontrolli tjetër?

Kontrolli i gjirit (mamografia) çdo 2 vjet midis moshës 50 dhe 74 vjeç është mënyra më e mirë për të zbuluar kancerin e gjirit herët. Do t'ju dërgojmë një letër për tju kujtuar kur të jetë koha për mamografinë e radhës. Nëse jeni 40 deri në 49 vjeç ose mbi 74 vjeç dhe keni të drejtë për kontroll, nuk do të merrni një letër për tju kujtuar, por mund ta lini takimin për kontroll të gjirit çdo 2 vjet.

Çfarë duhet të bëj mes kontrolleve?

Kanceri i gjirit mund të zhvillohet në çdo kohë. Edhe nëse bëni një kontroll të gjirit çdo 2 vjet, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për gjendjen e gjirit. Ne ju rekomandojmë të njiheni me pamjen dhe ndjesinë normale të gjinjve tuaj. Nëse vini re ndonjë ndryshim në gj, siç është ndonjë gungë e re, rrjedhje nga thithkat ose skuqje, bëni takim me mjekun tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Privatësia juaj

Në BreastScreen Victoria, përdorim të dhënat dhe rezultatet tuaja për kontrollin e kancerit të gjirit dhe për tju kujtuar për takimet e ardhshme. Vetëm personeli i autorizuar ka akses në të dhënat tuaja. Ne do të përdorim ose publikojmë vetëm informacione që ju identifikojnë me lejen tuaj, ose kur na kërkohet ta bëjmë këtë me ligj. Përdorimi i të dhënave për kërkime bëhet vetëm me miratim etik. Vizitoni: breastscreen.org.au/privacy

Na kontaktoni: info@breastscreen.org.au ose na telefononi në **13 20 50**.

Caktoni takim në:
breastscreen.org.au
ose **13 20 50**

TTY **13 36 77** nëse keni vështirësi
në dëgjim apo të folur



Për më shumë informacion ose për të ndryshuar të dhënat tuaja, vizitoni **breastscreen.org.au** ose telefononi **13 20 50**



Për të telefonuar me anë të një përkthyesi, telefononi **13 14 50**



Informacioni i përkthyer:
breastscreen.org.au/translations



BreastScreen Victoria falënderon
Qeverinë e Viktorias për mbështetjen.